



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:119878  
Datë: 13.03.2024  
Numri i dokumentit: 05443943

CML.nr.8/23

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Shukri Sylejmani, kryetar i kolegjit, Rrustem Thaqi dhe Nenad Lazic, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: N. I., A. B., Sh. Z., Xh. P. dhe Sh. P., të gjithë nga V., të cilët i përfaqëson - Zyra e avokatëve F. G. dhe K. F., me seli në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, për kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori i Shtetit, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.8826/2022, të datës 04.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 22.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.8826/2022, të datës 04.07.2023.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, C.nr.764/2021, të datës 21.11.2022, është vendosur: I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: N. I., A. B., Sh. Z., Xh. P. dhe Sh. P., të gjithë nga V., dhe detyrohet e paditura Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim në punë paditësit N. I. për periudhën nga data ... e deri më datë..., t'ia paguaj shumën prej ... €, paditësit A. B. për periudhën nga data ...e deri më datë..., t'ia paguaj shumën prej ... €, paditësit Sh. Z. për periudhën nga data ... e deri më datë..., t'ia paguaj shumën prej ... €, paditëses Xh. P. për periudhën nga data ...e deri më datë..., t'ia paguaj shumën prej ... €, dhe paditëses Sh. P. për periudhën nga data ... e deri më datë..., t'ia paguaj shumën prej ... €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data ... e deri në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim, e të gjitha këto në afat prej 7

ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. II. Detyrohet e paditura Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës, dhe atë: për padi shumë prej...€, dhe për taksën gjyqësore për padi shumë prej 20 €, apo shumë e përgjithshme prej ... €, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.8826/2022, të datës 04.07.2023, është vendosur: Refuzohet si e pabazuar ankesa e të së paditurës Komuna e Vushtrrisë - Drejtoria për Arsim, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri C.nr.764/2021, i datës 21.11.2022, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në afat ligjor ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë Prokurori i Shtetit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 247 paragrafi 1 pika b) e lidhur me nenin 398 të LPK-së, me propozim që: të aprovohet, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, dhe të priset aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.8826/2022 i datës 04.07.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, C.nr.764/2021, i datës 21.11.2022 dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ka pasur.

Për të vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 250 të LPK-së, ka caktuar seancë dëgjimore/seancën e kolegjit më datë 22.02.2024, në të cilën palët nuk kanë marr pjesë edhe pse të njëjtat ishin të ftuara në mënyrë të rregullt.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 245, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit më datë 11.06.2021, pranë gjykatës së shkallës së parë kanë ushtruar padi për kompensimin e shujtave për ditët e pranisë në punë, duke kërkuar më saktësisht si në padi.

Gjykata e shkallës së parë jashtë seancës gjyqësore ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.764/2021, të datës 21.11.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes, pasi që në mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Ka shtuar se nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura në padi, në precizimin e padisë dhe në përgjigjen në padi, gjykata ka gjetur se nuk ishte kontestuese se paditësit kanë themeluar

marrëdhënie pune, me të paditurën, fakt ky që konstatohet edhe nga kontratat e punës dhe atë për paditësin N. I. kontrata numër..., e datës 22.01.2018, për paditësin A. B. kontrata numër..., e datës..., për paditësin Sh. Z. kontrata numër..., e datës..., për paditësen Xh. P. kontrata numër..., e datës ... dhe për paditësen Sh. P. kontrata numër ..., e datës.... Kontestuese nuk ishte po ashtu rrethana se e paditura Komuna e Vushtrrisë, nuk ka bërë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë.

Gjykata e shkallës së parë, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: “ Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë ”.

Andaj duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), përkatësisht nenit 245 paragrafit 1, me të cilin përcaktohet se: “ Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij ”, e lidhur me nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë është 2 (dy) € për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore ”, si dhe vërtetimeve të lëshuara për paditësit nga SHFMU “...”, fshati S., K. V., dhe atë për paditësin N. I. vërtetimi i datës, për periudhën ...e deri më datë..., për paditësin A. B. vërtetimi i datës..., për periudhën nga data ...e deri më datë..., për paditësin Sh. Z. vërtetimi i datës..., për periudhën nga data ...e deri më datë..., për paditësen Xh. P. vërtetimi i datës..., për periudhën nga data ...e deri më datë ...dhe për paditësen Sh. P. vërtetimi i datës..., për periudhën nga data ...e deri më datë..., erdhi në përfundim se kërkesa e paditësve është e bazuar, andaj edhe paditësit N. I. ia njohu shumën prej ... €, duke përlllogaritur një ditë pune me ... € (...), paditësit A. B. i’a njohu shumën prej ... €, duke përlllogaritur një ditë pune me ... € (...), paditësit Sh. Z. i’a njohu shumën prej ... €, duke përlllogaritur një ditë pune me € ( ...), paditëses Xh. P. i’a njohu shumën prej ... €, duke përlllogaritur një ditë pune me ... € (...) dhe paditëses Sh. P., i’a njohu shumën prej nga . €, duke përlllogaritur një ditë pune me ... € (...).

Gjykata e shkallës së parë, kundërshtimin e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, gjykata e vlerësoj si të pabazuar pasi që në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 87 të tij është përcaktuar se: “ Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës, ndërsa paditësit kërkesën e tyre e kanë parashtruar për periudhën nga data ... deri më..., që përfshinë periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, ndërsa padinë e kanë paraqitur në gjykatë më...

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 245 të LMD-së, nenit 87 të Ligjit të Punës, nenit 253 dhe 398 të LPK-së, nenit 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Për kamatën gjykata ju ka referuar nenit

382 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.8826/2022, të datës 04.07.2023, ka vendosur që ta refuzojë si të pathemeltë ankesën e të paditurës, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se: nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e instancave më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shteti, mbështetet në pretendime të natyrës së tillë për të cilat kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e kufizuar, prandaj edhe vlerësohen si pretendime të pabazuara, për arsye se:

Me nenin 245 paragrafi 1, të LPK-së, përcaktohet se: “ Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë prokurori publik mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre muajsh...”.

Me nenin 246 të LPK-së, përcaktohet se: “ Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit nga neni 245 i këtij ligji ngritet nga prokurori publik, në pajtim me ligjin ”.

Me nenin 247 paragrafi 1 të LPK-së, përcaktohet se: “ Prokurori publik mund ta ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë: a) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore; b) për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale ”. Mirëpo në këtë çështje juridike – kontestimore, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk u referohet shkaqeve për të cilat ka të drejtë Prokurori i Shtetit që përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të kundërshtoj vendimet e formës së prerë.

Prokurori i Shtetit në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë i referohet shkeljeve me referencë në nenin 247 paragrafi 1, pika a), lidhur me nenin 398 të LPK-së, mirëpo kjo bazë ligjore nuk mund të shërbej për të kualifikuar pretendimet e Prokurorit të Shtetit si shkelje. Kjo nga shkaku

se edhe pse gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktgjykim pa mbajtur seancë gjyqësore, e njëjta nuk ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të lartcekura.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, sepse nga shkresat e lëndës shihet çartë se edhe pse në përgjigje në ankesë e paditura e ka kontestuar gjendjen faktike, gjykata e shkallës së parë nga shkresat e lëndës ka konstatuar me të drejtë se gjendja faktike është e qartë, sepse ka qenë fakt i pa kontestueshëm se paditësit kanë themeluar marrëdhënie pune te e paditura dhe ky fakt vërtetohet nga kontratat që gjenden në shkresa të lëndës.

Gjithashtu edhe pretendimin lidhur me parashkrimin e kërkesës të bërë nga e paditura me përgjigje në padi, gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë pretendim ka pasur prova të mjaftueshme për vlerësimin e të njëjtit pa mbajtur fare seancë gjyqësore, prandaj aktgjykimi është i drejtë dhe në përputhje me dispozitat e LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur sa i përket kundërshtimit lidhur me parashkrimin, për faktin se këto kërkesa janë parashtruar për periudhën 15.07.2019 deri më 15.03.2021, që përfshin periudhën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe ajo e datës 22.01.2021, e duke u bazuar në dispozitën ligjore nga nenin 87 i Ligjit të Punës, me të cilin përcaktohet se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës rezulton fakti kërkesëpadija e paditësve është e paraqitur brenda afatit të paraparë ligjor dhe se pretendimi për parashkrim të kërkesës i të paditurës është i pabazuar.

Përveç të cekurave për hir të praktikës gjyqësore në rastet ku Gjykata Supreme e Kosovës, vendosë për themelësinë e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, atëherë vendosë parimisht vetë me aktgjykim. Përjashtimisht vendosë me aktvendim edhe në rast të themelësisë së e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nëse janë plotësuar kushtet, siç përcaktohet me nenin 245 - 251 të LPK-së. Me nenin 247 të LPK-së, është përcaktuar se shkak për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë është shkelja e dispozitave të LPK-së, dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, dhe nëse Gjykata Supreme konstaton se e drejta materiale është zbatuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë ose gjykata e shkallës së dytë atëherë ajo vendosë vet me aktgjykim në kuptim të dispozitave të LPK-së, duke e aprovuar/refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Duhet të theksohet se konstatimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike nëse i referohemi nenit 247 të LPK-së, nuk është shkak për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Nga kjo rezulton se Gjykata Supreme është e lidhur me gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, përkatësisht gjykata e shkallës së dytë.

Nga përmbajtja e dispozitave të cituara rezulton se Gjykata Supreme do ta aprovojë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe do ta kthejë lëndën në rishqyrtim, nëse konstaton se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë me kusht që vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ka qenë si rezultat - gjegjësisht pasojë e zbatimit të gabuar të së drejtës materiale ose e ndonjë shkelje të dispozitave të LPK-së. Nga kjo rezulton se Gjykata Supreme, do ta kthejë lëndën në rishqyrtim nëse gjykatat e instancave më të ulëta pa të drejtë nuk kanë lejuar marrjen në pyetje të një dëshmitari, nxjerrjen e provës me ekspertim... etj, dhe si pasojë e kësaj shkelje është konstatuar gjendja faktike në mënyrë jo të plotë, mirëpo duhet të merret për bazë fakti se vërtetimi jo i plotë ose i gabuar i gjendjes faktike duhet të jetë gjithmonë pasojë e zbatimit të gabuar të së drejtës

materiale ose pasojë e një shkelje të dispozitave të LPK-së. Pra në këto raste Gjykata Supreme para se të vendosë siç përcaktohet me dispozitat e cituara të LPK-së, duhet gjithmonë të konstatojë edhe lidhjen kauzale në mes të një shkelje të dispozitave të LPK-së, ose zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës, nuk e ka shqyrtuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, bazuar në provat prezentë në shkresat e lëndës, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, edhe për faktin se në këtë rast nuk ekziston lidhja kauzale në mes të një shkelje të dispozitave të LPK-së, ose zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me vërtetim të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike nga gjykata e instancave me të ulëta.

Po ashtu për të vendosur siç përcaktohet me dispozitat e LPK-së, është me rendësi edhe fakti se Gjykata Supreme, nuk mund të ndryshoj vet aktgjykimin e goditur sipas mjeteve të jashtëzakonshme të goditjes, për shkak të konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, e cila gjendje është ardhur si pasojë e zbatimit të gabuar të drejtës materiale ose shkeljet e ndonjë dispozite procedurale.

Në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se kthimi i çështjes në rigjykim do të ishte i pa efekt, dhe se rezultati i gjykimin do të ishte i njëjtë, për arsyet e cituara. Përveç kësaj në rastet kur gjykata me e lartë e kthen lëndën në rigjykim, në gjykatën e shkallës më të ulët, gjykata e shkallës më të lartë duhet që ti konstatoj shkeljet e dispozitave të LPK-së, dhe në çka konsiston shkelja duke sugjeruar se cilat veprime konkret duhet të ndermirën, dhe cilat prova duhet të nxirren dhe administrohen nga ana e gjykatës së shkallës me të ulët me rastin e rigjykimin.

Në këtë rast nuk është konstatuar se aktgjykimet e gjykatave të instancave me të ulëta janë përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së, mirëpo bazuar në provat e prezent në shkresat e lëndës, mbi gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale, andaj kthimi i çështjes në rigjykim do të ishte i pa efekt, për arsyet e theksuar si me lartë.

Parashtrimet e Prokurorit të Shtetit, si në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, sa i përket shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të pabazuara, dhe se aktgjykimet e instancave me të ulëta nuk janë përfshirë në shkeljet e pretenduara, dhe as me shkeljet të cilat shikohen sipas detyrës zyrtare siç përcaktohet me dispozitat e LPK-së.

Andaj nga të cekurat më lartë shihet në mënyrë të çartë se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga nenin 398 i LPK-së, që gjykata e shkallës së parë të vendos lidhur me kërkesëpadinë e paditësit pa mbajtur seancë gjyqësore, prandaj nga kjo rezulton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga Prokurori i Shtetit është në tërësi e pabazuar.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u mbështetur në nenin 245 dhe 246 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:119878  
Datë: 13.03.2024  
Numri i dokumentit: 05443943

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CML.nr. 8/23, më datë 22.02.2024

Kryetari i kolegjit  
Shukri Sylejmani